

# MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMJËT



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTËR I SHTETIT  
PËR RININË DHE FËMJËT

RAPORT MONITORIMI PËR  
ZBATIMIN E PLANIT TË  
INTEGRITETIT  
Raportim mbi 6 mujorin e parë  
**Janar- Qershor 2024**

## **Përmbledhje e Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët:**

Plani i Integritetit për Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF) u hartua gjatë periudhës Korrik – Shtator 2023. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për qeverisjen qendrore. Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është: i) vlerësimi i risqeve të integritetit, me të cilat mund të përballen zyrtarët e lartë të MSHRF-së dhe punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR) gjatë ushtrimit të detyrave të tyre me paanshmëri dhe përgjegjshmëri, si dhe ii) parashikimi i masave për adresimin e tyre.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe shkakut të tyre i referohet proceseve të punës sipas fushës së përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe përfshijnë: i) risqe të lidhura me kuadrin rregullator dhe institucional; ii) risqe të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore; iii) risqe të lidhura me transparencën dhe komunikimin me aktorët e jashtëm; iv) risqe të lidhura me financimin e projekteve për organizatat rinore/për të rinjtë.

**Plani i Veprimit** përfshin tërësinë e masave për trajtimin dhe adresimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, të identifikuar sipas fushës së përgjegjësisë së MSHRF-së dhe proceseve të punës më të ekspozuara. Ky dokument përbën një mekanizëm për menaxhimin dhe kontrollin e riskut, duke synuar eliminimin e tij, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të parashikuara në të, afateve për zbatimin e tyre dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse. Plani i Veprimit ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

- Objektivi 1. Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional mbi integritetin dhe etikën, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të dokumenteve përkatëse;
- Objektivi 2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe rritja e kualifikimit të tyre nëpërmjet trajnimeve të lidhura me shmangien e shkeljes së integritetit;
- Objektivi 3. Rritja e transparencës dhe komunikimi me publikun dhe aktorët e jashtëm të lidhur me veprimtarinë e MSHRF-së dhe AKR-së;
- Objektivi 4. Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të financimit të projekteve për organizatat rinore /për të rinjtë.

**Monitorimi** i zbatimit të Planit të Veprimit, masave dhe aktiviteteve të parashikuara në të do të kryhet periodikisht, konkretisht çdo një vit, dhe përfshin verifikimin e zbatimit të detyrave të ngarkuara, brenda afateve të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse, për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të miratuara në planin e veprimit. Pjesë e monitorimit do të jetë vlerësimi i efektshmërisë së masave të zbatuara, impaktit pozitiv që kanë sjellë ato në uljen e risqeve të integritetit dhe eliminimin e faktorëve të tyre, me qëllim vlerësimin e rishikimit të masave ekzistuese dhe parashikimin e masave të reja në të ardhmen.

## **Raportimi 6- mujor i monitorimit të Planit të Integritetit, Janar-Qershor 2024:**

Në vijim të miratimit të Planit të Integritetit të MSHRF-së dhe Planit të Veprimit të tij 2024-2025 më datë 29.09.2023, dërguar me shkresën me Nr. Prot. 3089/2, datë 29.09.2023 pranë Ministrisë së Drejtësisë, gjatë periudhës raportuese ka vijuar zbatimi i objektivave të Planit të Veprimit 2024-2025, me qëllim forcimin e integritetit.

**Lidhur me objektivin 1** të Planit të Veprimit “Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional mbi integritetin dhe etikën, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të dokumenteve përkatëse”, janë realizuar masat në zbatim të këtij objektivi, si më poshtë vijon:

- Në mbështetje të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, MSHRF është pjesë e strukturës organizative të Kryeministrit dhe zbaton rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Kryeministrit”, e cila përcakton rregullat për organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet nëpërmjet niveleve të ndryshme të strukturave organizative të Kryeministrit, detyrat e tyre, rregullat për administrimin e dokumentacionit e të pajisjeve, rregullat e etikës e të administrimit të brendshëm të institucionit.
- Me anë të Urdhrit nr. 11 datë 29 Shator 2023 “Për Miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit Brendshëm të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” është miratuar Rregullorja e Brendshme e AKR-së, e cila përmban reflektimin e strukturës së brendshme institucionale, përfshirjen e detyrave/kompetencave për secilën njësi të institucionit, përcaktimin e rregullave të qarta të komunikimit dhe raportimit ndërmjet tyre, komunikimin me institucione të tjera dhe aktorë të jashtëm, parashikimin e rregullave për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale etj. Në vijim, të Urdhrit të Kryeministrit nr. 58 datë 18.04.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, AKR është ristrukturuar. Procesi i ristrukturimit ka sjellë nevojën për miratimin e një rregulloreje të re e cila do të saktësojë qëllimin dhe detyrat e njësive organizative të AKR-së, rregullat mbi marrëdhëniet e punës të punonjësve të AKR si dhe dispozita të tjera që rregullojnë proceset e punës. *Aktualisht rregullorja është në fazat e fundit të rishikimit dhe pritet të dërgohet për miratim.* Në rregullore do të parashikohen gjithashtu dispozita që do të adresojnë uljen e veprimit e faktorëve të riskut të integritetit.

**Lidhur me objektivin 2** “Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe rritja e kualifikimit të tyre nëpërmjet trajnimeve të tyre të lidhura me shmangien e shkeljes së integritetit”, janë realizuar masat në zbatim të këtij objektivi, si më poshtë vijon:

- Kabineti i MSHRF-së ka marrë pjesë më datë 1 Mars 2024 në eventin lancues të platformës online HELP “Për Parandalimin e Korrupsionit”, me synim rritjen e kapaciteteve të këshilltarëve të kabineteve për integritetin dhe politikën kundër korrupsionit. Në vijim këshilltarët politikë në kabinetin e MSHRF i janë nënshtruar trajnimeve online të ofruara nga platforma HELP “Për Parandalimin e Korrupsionit”. Gjithashtu, MSHRF është në proces rishikimi të mundësive për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe organizimin e trajnimeve me qëllim rritjen e kualifikimit për shmangien e shkeljes së integritetit.
- Përshkrimet e punës për punonjësit e AKR-së janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të AKR-së, miratuar me Urdhrit nr. 11 datë 29 Shator 2023. Gjithashtu, në vijim të hartimit të rregullores së re, do të parashikohen përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e punës sipas strukturës së re miratuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 58 datë 18.04.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë”.
- Lidhur me ngritjen e një sistemi të vlerësimit të performancës për punonjësit e AKR-së, është miratuar formati i vlerësimit të performancës së punonjësve me urdhër Nr. 129, datë 26.07.2024 “Për miratimin e përkohshëm të formatit të vlerësimit të punonjësve”, përmes të cilit do të vlerësohen detyrat e punëmarrësve në kuadër të detyrave sektorit ku bën pjesë për periudhën që mbulon vlerësim bazuar në:
  - ✓ planifikimin dhe koordinimin e programeve/aktiviteteve të ideuar për zhvillim nga dhe te AKR-ja;
  - ✓ raportimi i punës ditore, javore dhe mujore te drejtuesi i institucionit të AKR-së;
  - ✓ realizimi në kohë i punës;

- ✓ gatishmëria për punën në grup;
- ✓ etika në punë etj.
- Ndërkohë, lidhur me procedurat e rekrutimit të punonjësve, këto procedura bazohen tek Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, në draft rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKR-së janë parashikuar rregulla të detajuara mbi marrjen në punë të punonjësve.
- Lidhur me rritjen e kualifikimit të stafit duhet theksuar se AKR informon vazhdimisht stafin lidhur me zhvillimin e trajnimeve brenda dhe jashtë vendit për tema që lidhen me objektin e punës së tyre. Në vëmendje të veçantë janë pjesëmarrja e stafit në trajnime që lidhen me integritetin dhe etikën në punë.

**Lidhur me objektivin 3** “Rritja e transparencës dhe komunikimi me publikun dhe aktorët e jashtëm të lidhur me veprimtarinë e MSHRF-së dhe AKR-së”, janë realizuar të gjitha masat në zbatim të këtij objekti, si më poshtë vijon:

- Përditësimi i faqeve zyrtare web të MSHRF-së dhe AKR-së me qëllim rritjen e transparencës për veprimtarinë e dy institucioneve, publikimin e thirrjeve të hapura dhe publikimin e rezultateve të tyre, publikimin e informacionit mbi këshilltarët politikë në kabinetin e MSHRF, profilizimin dhe veprimtarinë e tyre, përditësimi i faqes zyrtare të AKR me programin e transparencës si dhe të gjithë dokumenteve që janë pjesë e Programit të Transparencës. Informacionet si më sipër janë publikuar zyrtarisht në faqet [www.riniafemijet.al](http://www.riniafemijet.al) dhe [www.rinia.gov.al](http://www.rinia.gov.al).
- Në kuadër të thirrjeve të dedikuara të AKR-së për rininë, përmbledhjet e projekteve fituese janë publikuar të qarta në faqen zyrtare të AKR-së së bashku me shumën e grantit që financohet nëpërmjet thirrjes përkatëse. Specifikisht, më datë 04.03.2024 është publikuar lista e projekteve fituese të Thirrjes së 3-të të AKR-së për grante për infrastrukturë rinore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

**Lidhur me objektivin 4** “Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të financimit të projekteve për organizatat rinore/për të rinjtë”, MSHRF është në proces të digjitalizimit të thirrjeve me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Aktualisht, është në proces finalizimi i Termave të Referencës për sistemin elektronik për implementimin e thirrjeve të dedikuara për rininë. Gjithashtu, nga ana e AKR-së janë organizuar 3 sesione informuese me qëllim prezantimin e Thirrjes nr. 4 për projekt-propozime të organizatave rinore/për të rinjtë, përkatësisht në datat 30.04.2024, 08.05.2024 dhe 13.05.2024.